



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHENDETËSISË
BORDI KOMBËTAR I RICERTIFIKIMIT DHE AKREDITIMIT**

Bulevardi "Bajram Curri" Nr 1 Tirane, Shqipëri, Tel: 0035542362937, www.shendetesia.gov.al

Nr.4601 prot.

Tiranë, më 09/07/ 2014

V E N D I M

Nr. 295, datë 08/ 07/ 2014

PËR

**DISA NDRYSHIME NË DOKUMENTET RREGULLATORË TË RICERTIFIKIMIT
DHE AKREDITIMIT TË AKTIVITETEVE TË EDUKIMIT NË VAZHDIM PËR
PROFESIONISTËT E SHËNDETËSISË**

Në mbështetje të nenit 33 "Edukimi i Vazhdueshëm Profesional", të ligjit "Për kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë" nr.10107 datë 30.03.2009, Bordi i Ricertifikimit dhe Akreditimit mbledhur më datë 03.07.2014

Vendosi:

1. Miratimin e ndryshimeve në "Dokumentin rregullator për ricertifikimin e profesionistëve të shëndetësisë" (Urdhër nr. 554 datë 22.10.2009) dhe në "Dokumentin rregullator të akreditimit të aktiviteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë" (Urdhër nr. 417 datë 23.07.2009).
2. Për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi ngarkohen:

Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim
Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë
Autoriteti Shëndetësor Rajonal Tiranë
Drejtoritë e Shëndetit Publik
Drejtoritë e Shërbimeve Spitalore Rajonale
Spitali Universitar Obstetrik – Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë” Tiranë
Spitali Universitar Obstetrik – Gjinekologjik “Koço Gliozheni” Tiranë
Spitali Universitar i Sëmundjeve të Mushkrive “Shefqet Ndroqi” Tiranë
Urdhri i Mjekëve të Shqipërisë
Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë
Urdhri i Infermierëve të Shqipërisë

MINISTRI

ILIR BEQAJ

Disa ndryshime në Dokumentin Rregullator të Ricertifikimit të Profesionistëve të Shëndetësisë

1. Në kapitullin I, gërma B, në fund të paragrafit *Pjesëmarrës në programin e ricertifikimit ...* shtohet si vijon: “Përjashtohen nga ky detyrim profesionistët që punojnë në administratë”.

2. Në kapitullin II, gërma C, paragrafi i tretë hiqet dhe zëvendësohet me paragrafin si më poshtë:

“ Në ciklet pasardhëse kërkesat e programit të ricertifikimit do të mbeten të njëjta me ato të ciklit të parë. Numri i rekomanduar i krediteve për çdo vit është 30 për mjekët dhe 20 për farmacistët dhe stomatologët”.

3. Në kapitullin III, pika 1: *Aktivitete të edukimit në vazhdim të akredituara paraprakisht...* shtohet paragrafi i mëposhtëm:

Për çdo cikël udhëheqjeje të praktikës profesionale, profesionistët që janë miratuar si udhëheqës praktike nga Urdhrat përkatës të profesionistëve, përfitojnë kredite sipas kriterit 1 cikël ndjekje praktike – 10 kredite.

4. Në kapitullin V, gërma B, në vijim të pikës 1a. shtohet paragrafi:

“Në rastet kur profesionisti ka marrë pjesë si lektor në aktivitete të edukimit në vazhdim me kohëzgjatje më shumë se një javë, llogaritja e krediteve do të bëhet mbi bazën e orëve të leksioneve të kryera, sipas të njëjtit kriter 1 orë x 1.5 kredite”.

5. Në kapitullin V, gërma B, pika 3.a, në fund të paragrafit të parë shtohet fjalia:

“Gjithashtu, regjistrimi i krediteve të aktiviteteve të të mësuarit në distancë, të akredituara nga QKEV, kryhet dhe mbi bazën e listës së pjesëmarrësve të dorëzuar nga organizatori i aktivitetit të të mësuarit në distancë”.

6. Në kapitullin V, gërma C, paragrafi i katërt dhe i pestë hiqen dhe zëvendësohen me:

Për profesionistët e sektorit publik sanksionet janë si më poshtë:

Atyre profesionistëve që në përfundim të ciklit të parë kanë 0 kredite, vendi i punës iu bëhet vakant dhe iu pezullohet licenca. Që prej ditës kur njoftohen nga QKEV, drejtuesit e institucioneve shëndetësore kanë përgjegjësinë për shpalljen e vendit vakant, çdo tre muaj brenda vitit, deri në paraqitjen e një kandidature të përshtatshme. Njëkohësisht, urdhri profesional përkatës pezullon licencën. Këta profesionistë rifitojnë të drejtën për tu punësuar dhe licencuar vetëm pas dhënies së provimit të shtetit.

Profesionistët me më shumë se 0 kredite por më pak se limiti i kërkuar, do të vazhdojnë punën por ndërkohë duhet të japin provimin e shtetit brenda 6 muajve që prej ditës kur njoftohen nga QKEV, në të kundërt, pas 6 muajsh edhe këtyre profesionistëve vendi i punës iu bëhet vakant dhe iu pezullohet licenca. Drejtuesi i institucionit shëndetësor ka përgjegjësinë për shpalljen e vendit vakant çdo tre muaj brenda vitit pasardhës, deri në paraqitjen e një kandidature të përshtatshme, njëkohësisht urdhri profesional përkatës pezullon licencën. Këta profesionistë rifitojnë të drejtën për tu punësuar dhe licencuar vetëm pas dhënies së provimit të shtetit.

Për profesionistët e sektorit privat që në përfundim të ciklit të parë kanë 0 kredite, urdhri profesional përkatës pezullon licencën, pas njoftimit nga QKEV. Këta profesionistë fitojnë të drejtën për tu rilicencuar vetëm pas dhënies së provimit të shtetit.

Profesionistët e sektorit privat që kanë më shumë se 0 kredite por më pak se limiti i kërkuar do të vazhdojnë punën por ndërkohë duhet të japin provimin e shtetit brenda 6 muajve, që prej dites kur njoftohen nga QKEV, në të kundërt pas 6 muajsh edhe këtyre profesionistëve iu pezullohet licenca. Këta profesionistë fitojnë të drejtën për tu rilicencuar vetëm pas dhënies së provimit të shtetit.

Provimi i shtetit për të gjithë profesionistët që nuk përmbushin kërkesat do të administrohet nga Agjencia Kombëtare e Provimeve. Shpenzimet për kryerjen e provimit mbulohen nga vetë profesionisti.

7. Në kapitullin V shtohet gërma D “Mekanizma motivues” me përmbajtjen si më poshtë:

Në mbështetje të nenit 33 të ligjit për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë dhe për të lehtësuar procesin e ricertifikimit për profesionistët e shëndetësisë, institucionet shëndetësore dhe aktorët e tjerë të sistemit të edukimit në vazhdim duhet të vënë në zbatim disa mekanizma motivues për profesionistët si më poshtë:

1. Përfshirja e detyrimeve të programit të ricertifikimit në kontratat individuale të spitaleve e qendrave shëndetësore me mjekët dhe personelin e përfshirë në programin e ricertifikimit.
2. Përfshirja e indikatorit të edukimit të vazhdueshëm në kontratat e FSDKSH me spitalet.
3. Promovimi i mjekëve në pozicionin e shefit të klinikës ose të shërbimit të kushtëzohet nga plotësimi i numrit të rekomanduar vjetor të krediteve të edukimit në vazhdim.

Disa ndryshime në “Dokumentin rregullator për Akreditimin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë”

1. Faqe 9 , paragrafi 4 është : *Ofrues të aktiviteteve të edukimit në vazhdim* janë të gjitha institucionet akademike ose jo akademike, fitimprurëse ose jo fitimprurëse, që kanë ekspertizë dhe eksperiencë në organizimin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim në fushën e shëndetësisë;

ndryshohet në:

Ofrues të aktiviteteve të edukimit në vazhdim janë të gjitha institucionet akademike ose jo akademike, fitimprurëse ose jo fitimprurëse të regjistruara si të tilla në Republikën e Shqipërisë, që kanë ekspertizë dhe eksperiencë në organizimin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim në fushën e shëndetësisë.

